



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë/Datum/Date:	11.07.2025
Për/Za/To:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës
Nga/Od/From:	Shkelzen Hajdini – Drejtor i DSHPS –së
Lënda/Subjecat/Subject:	Raport Mujor – Qershor 2025

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur ju lutem gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për periudhën 01.06.2025 deri 30.06.2025.

RAPORT MUJOR PËR MUAJIN QERSHOR 2025

1. Përmbledhje ekzekutive

Më 11 qershor 2025, në QKMF Lipjan është organizuar Mbledhja e Komitetit Drejtues, Projekti i Kujdesit Shëndetësor të Qasshëm dhe Cilësor (AQH), Faza III (2024-2027).

Gjatë këtij muaji është vërejtur një numër i madh pacientësh që kanë kërkuar trajtim, kryesisht për shkak të ngritjes së temperaturave të verës dhe virozave sezonale, duke shkaktuar ngarkesë të lartë veçanërisht në dhomat e infuzioneve dhe injeksioneve.

Kemi bërë përgatitjet për një vizitë për shkëmbim të përvojave që do të mbahet në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Gadime, të mërkurën 02 korrik 2025. Kjo vizitë do të organizohet në kuadër të projektit AQH dhe në bazë të interesimit dhe nevojës së komunave të reja partnere për t'u njohur më nga afër me funksionimin e Këshillimoreve.

Të gjitha shërbimet në QKMF dhe punkte janë ofruar pa ndërprerje dhe janë mbuluar me personel të mjaftueshëm mjekësor.

Punimet në ndërtimin e objektit të ri të Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit kanë vazhduar edhe në këtë muaj.

2. Punët dhe aktivitetet e realizuara, bazuar në Planin e Punës së DHSPS-së për vitin 2024

Më qëllim të ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore në QKMF, është vazhduar me zhvillimin e edukimit të vazhdueshëm profesional për personelin shëndetësor.

Numri i ekzaminimeve mamografike të kryera në QKMF gjatë këtij muaji ka qenë i ulët. Gjithsej janë ekzaminuar 6 gra. Ky numër vazhdon me qenë shumë i ulët.

Në bazë të raporteve nga intervenimi i shërbimit të urgjencës të pranuar nga QKMF, në muajin Qershor janë shënuar 40 aksidente trafiku. Krahasuar me muajin e kaluar, numri i rasteve të aksidenteve në trafik në këtë muaj ishte më i lartë, 4 raste më shumë se në muajin paraprak.

Furnizimi nga Ministria e Shëndetësisë me barna esenciale ka avancuar megjithatë ende ka qenë i pjesshëm dhe nuk ka arritur të mbulojë të gjitha nevojat.

Bazuar ne raportin nga QKMF, nga furnizimi me material shpenzues dhe pajisje laboratorike nga Ministria e Shëndetësisë janë plotësuar afërsisht 70% e nevojave të raportuara.

Shuma e të hyrave nga participimi në muajin qershor ka qenë 6,393.50 €.

Përqindja e referimeve të jashtme për në shërbimin sekondar dhe terciar dhe sekondar gjatë këtij muaji ka qenë 9.51 % . Kjo përqindje, siç është raportuar nga QKMF, vazhdon të mbetet në kuadër të përqindjes së lejuar për referimet nga KPSH.

3. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare QKMF

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF) gjatë muajit Qershor janë kryer 38191 vizita dhe shërbime shëndetësore.

Stafi mjekësorë	Niveli i arsimimit	Meshkuj	Femra	Numri i punëtorëve gjithsej
Specialist të Mjekësisë Familjare	Superior/Specializim nga mjekësia familjare 26	13	13	26
Mjekë të Përgjithshëm	Superior/Master i mjekësisë së Përgjithshme 20	11	9	20
Doktor i Stomatologjisë	Superior/Master i Stomatologjisë 10	5	5	10
Specialist Radiolog	Superior/Specializim në Radiologji 1	1	0	1
Specialist i Pediatriisë	Superior/Specializim në Pediatri 1	1	0	1
Specialist Gjinekolog-Obstetër	Superior/Specializim në Gjinekologji me Obstetrikë 2	2	0	2
Specialist i Biokimisë	Superior/Specializim në Biokimi-Klinike 1	1	0	1
Teknik Laborant mjekësorë	Bachelor-4, Shkolla e mesme - 8	8	4	12
Infermier/e	Shkolla e mesme= 84 Bachelor=29	17	96	113
Mami	Shkolla e mesme-12	0	12	12
Teknik të stomatologjisë	Shkolla e mesme-6	2	3	5
Teknik të radiologjisë	Shkolla e mesme-3	2	2	4
Punëtor teknik	Shkolla e mesme-19, shkolla e mesme e ulet-4	12	11	23
Punëtor në administratë	Shkollim superior-4 Shkollim i mesëm-4	7	1	8
Numri i punësuarve nga	Shkolla e mesme-3	1	2	3

komuniteti jo shumice				
Numri i punëtorëve me nevoja të veçanta	Shkolla Fillore- 2 Shkolla e mesme-2	3	1	4
Gjithsej numri i punëtorëve	Shkollim superior =64, Shkollim bachelor =33, Shkollimi i mesëm=137, Shkollimi i mesëm i ulët = 4	90	148	238

Totali i vizitave dhe shërbimeve shëndetësore në muajin Qershor 2025:

Qershor 2025-Vizitat Mjekësore

1	Vizita mjekësore nga mjeku Familjar /Përgjithshëm në QKMF	8218
2	Vizita mjekësore nga mjeku Familjar /Përgjithshëm në Punte	3890
3	Vizita mjekësore Pediatrike	0
4	Vizita mjekësore Gjinekologjike	191
5	Vizita mjekësore Stomatologjike	557
6	Vizita mjekësore Pulmologjike	30
7	Vizita mjekësore Emergjente	4897
8	Vizita në kujdesin Paliative	242
9	Total	18025

Qershor 2025- Shërbime Shëndetësore

1	Injeksione	6133
2	Infuzione	3754
3	Pastrim lidhje	1709
4	RTG	402
5	Laborator	2739
6	Lindje	0
7	Largim i penjve	80
8	Imobilizime	47
9	Oksigjenoterapi	102

10	EKG	435
11	Mamografi	6
12	USG	103
13	Vizita Shtëpiake me Autoambulancë	95
14	Transport me Autoambulancë	83
15	Vizita në Stacionin Policor	0
16	Vizita në Qendrën e Azilit - Magure	5
17	Vizita në Qendrën e Paraburgimit	17
18	Rrahje	7
19	Këmbësor i lënduar me automjet	0
20	Konstatim vdekje	13
21	Plagosje me armë zjarri	0
22	Thumbim i rrigrave	64
23	Aksidente trafiku	40
24	Dhunë familjare	0
25	Exitus letalis / mortus ad latae	0
26	Këshillimorja	958
27	Vaksina	888
29	Shërbime stomatologjike	1715
30	Referime	622
31	Inhalime	4
32	Vizita infermieri gjinekologjike	24
33	Vizita për nëna dhe fëmijë 0-3 vjet	67
34	Klasa për nëna	54
33	Gjithsej shërbime	20166

4. Qendra për Punë Sociale QPS

Të dhënat numerike për numrin e klientëve dhe shërbimeve në aspektin e klientëve dhe shërbimeve të asistencës në raste dhe për ndihmë sociale gjatë muajit, Qershor/2025.

Tab. 1. Shërbimin Social: Shërbimet dhe klientët.

Klientët	Numri i rasteve	Shërbimet	Numri i rasteve
<i>Fëmijët e keqtrajtuar- abuzuar (lënë pas dore)</i>	/	<i>Shërbime për të miturit në konflikt me Ligjin.</i>	6
<i>Të mitur në konflikt me ligjin.</i>	6	<i>Këshillim për bashkëshortet në martesë</i>	2
<i>Klient në nevojë për këshillime martesore.</i>	/	<i>Bashkimi familjar-kthimi në familje</i>	0
<i>Riintegrim i fëmijëve</i>	/	<i>Shërbime për të moshuarit</i>	2
<i>Fëmijë me sjellje asociale- vështirësi në sjellje</i>	8	<i>Intervenim i Viktimave</i>	6
<i>Të moshuarit në nevojë për shërbime</i>	2	<i>Besimi i fëmijëve dhe mbikëqyrja e vizitave prindërore</i>	7
<i>Klient me aftësi të kufizuara- Fëmijë</i>	4	<i>Shërbime për fëmijë me aftësi të kufizuara</i>	30
<i>Viktima e dhunës në familje</i>	6	<i>Shërbime për fëmijë me sjellje asociale</i>	8
<i>Viktimat e dhunës në familje/ Urdhëri për mbrojtje</i>	1	<i>Këshilla Psiko-Sociale</i>	4
<i>Viktimat e krimeve seksuale</i>	2	<i>Intervenime gjatë orarit të Kujdestarisë</i>	3
<i>Kujdestari për fëmijët e pa shoqëruar (me status të huaj dhe mbrojtje ndërkombëtare)</i>	/	<i>Pjesëmarrje në PTHT/GJTHP</i>	1
<i>Kërkesë për kontaktim</i>	2	<i>Përfaqësues të përkohshëm</i>	1
<i>Klient të tjerë në nevojë për shërbime</i>	81	<i>Intervenime të përgjithshme</i>	585
<i>Nr. i përgjithshëm i klientëve.</i>	102	<i>Nr. i Përgjithshëm i Shërbimeve</i>	663

Tabela 2. Shërbimet e asistencës sociale.

	Aktivitetet	Kategoria 1	Kategoria 2	Gjithsej
APLIKIMI	1.Numri i rasteve që kanë aplikuar për herë të parë.	2	3	5
	<i>Sa prej tyre janë të aprovuara.</i>	2	3	5
	<i>Sa janë në shqyrtim .</i>	0	0	0
	<i>Sa prej tyre janë të refuzuara.</i>	0	0	0
RIAPLIKIMI	2. Numri i rasteve të larguara për mos ri-aplikim.	4	3	7
	2.1 Numri i rasteve që kanë ri-aplikuar.	35	44	79
	2.2 Numri i rasteve të larguar për mungesë të dokumentacioni.	3	4	7
VERIFIKIMI	3.Numri total i familjeve të verifikuara/ri-verifikuara.	38	47	85
	<i>Sa prej tyre janë aprovuar</i>	32	41	73
	<i>Sa prej tyre janë refuzuar/çregjistruar</i>	6	6	12
KOMISIONI MJEKËSOR	4. Numri i rasteve të dërguara në Komision Mjekësor (KM) .	55	0	55
	<i>Numri i rasteve të aprovuara nga KM.</i>	55	0	55
	<i>Numri i rasteve të refuzuara nga KM.</i>	0	0	0
	<i>Numri i rasteve të kthira nga KM për kompletim dokumentacioni .</i>	0	0	0
	3.Numri i ankesave të paraqitura nga shfrytëzuesit.	0	0	0
	<i>A. Në shkallë të parë(I).</i>	0	0	0

	<i>B. Në shkallë të dytë(II)</i>	0	0	0
	<i>Numri i ankesave të aprovuara.</i>	0	0	0
	<i>Numri i ankesave të refuzuara.</i>	0	0	0
	<i>Numri i ankesave në shqyrtim.</i>	0	0	0
	<i>Kontestet në Gjykata.</i>	0	0	0
	<i>a)Kontestet të pranuar.</i>	0	0	0
	<i>b)Konteste të refuzuara.</i>	0	0	0
	Gjithsej			383

5. Shtëpia me Bazë në Komunitet

Gjendja shëndetësore e rezidentëve gjatë këtij muaji në përgjithësi ka qenë e mirë.

6. Investimet Kapitale

Projekti Ndërtimi i Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit është duke vazhduar.

7. Vështirësitë dhe sfidat

- Reduktim i hapësirave të punës si pasojë e punimeve për ndërtimin e objektit të ri.
- Mungesë e stafit teknik dhe mbështetës në QKMF, si dhe prezenca e stafit të moshuar në këtë sektor.
-

8. Planifikimi për muajin Korrik 2025

- Do të mobilizohemi dhe do të bëjmë përgatitjet për të përballuar sfidat sezonale të cilat priten gjatë muajve të pushimit Korrik dhe Gusht. Gjatë këtyre muajve pritet të rritet numri i pacientëve për shkak të ardhjes së mërgimtarëve dhe mbretërimit të temperaturave të larta.
- Parashihet zbatimi i aktiviteteve sipas planit të veprimit për vitin 2025, me fokus në ofrimin dhe forcimin e shërbimeve të integruara shëndetësore.
- Do të vazhdohet me edukimin profesional të vazhdueshëm të stafit mjekësor, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.